STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 14 nëntor 2012

**GUVERNATORI NJOFTON SE KATER QARQE TE TJERA TE PREKURA NGA URAGANI SENDI (SANDY) KANE TE DREJTEN E NDIHMES SE ASISTENCES FEDERALE PUBLIKE**

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se katër qarqe të tjera janë miratuar tani për fonde shtesë sipas Programit të Asistencës Publike të FEMA-s. Qarqet Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulstër (Ulster) kanë tani të drejtë për këtë ndihmë.

"Janë bërë dy javë që kur Sendi (Sandy) goditi Shtetin e Nju Jorkut dhe vazhdojmë të shohim pasojat në një sferë të gjërë, katastrofike të kësaj stuhie anembanë Luginës së poshtme të Hadsonit (Hudson)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Falënderoj Presidentin Obama dhe FEMA-n për zgjerimin e asistencës federale për këto katër qarqe."

Më 30 tetor, Presidenti Obama pranoi kërkesën e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) për një deklaratë federale të katastrofës për shtatë qarqe: Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Riçmond (Richmond), Kuins (Queens) dhe Safolk (Suffolk). Më 2 nëntor, Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi se dy qarqe të tjera, Roklënd (Rockland) dhe Uestçester (Westchester) ishin miratuar që të merrnin ndihmë federale të katastrofës si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy). Më 12 nëntor, Guvernatori njoftoi se qarqet Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulstër (Ulster) ishin miratuar për ndihmë të Asistencës Individuale federale.

Qarqet që tani kanë të drejtë për Asistencë Individuale dhe Publike: Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Kuins (Queens), Safolk (Suffolk), Sallivën (Sullivan), Ulstër (Ulster) dhe Uestçester (Westchester).

Të gjitha 13 qarqet kanë të drejtë për rimbursim federal për veprimet e emergjencës të mara gjatë dhe menjëherë pas një katastrofe për të mbrojtur jetën dhe pasurinë, heqjen e mbeturinave, rivendosjen e infrastrukturës së dëmtuar nga katastrofa, sistemet rrugore, mjediset e kontrollit të ujit, ndërtesat dhe pajisjet publike, shërbimet publike dhe parqet e argëtimin.

Programi i Asistencës Publike të FEMA-s siguron grante për qeveritë e Shtetit, fiseve dhe pushtetin vendor e disa organizata jo-fitimprurëse private për masa të mbrojtjes në emergjencë dhe riparimin, rivendosjen dhe zëvendësimin e infrastrukturës së dëmtuar, në mënyrë që komunitetet të reagojnë dhe të rimëkëmben shpejt nga katastrofat dhe emergjencat e mëdha të shpallura nga Presidenti.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418